



European  
Commission

U japim jetë  
ideve

CodeWeek. 

6-21  
tetor 2018

# Festa e krijimit me kod

Në Evropë po rriten kompetencat dixhitale! Bëhuni pjesë e EU Code Week dhe mësoni se si të shprehni përmes kodimit. Krijoni një aplikacion, një lojë, një faqe interneti, krijoni një histori interaktive ose, pse jo, provoni të riparoni një pjesë elektronike, apo të bëni një robot të lëvizë? Organizoni evenimente kodimi për fëmijët tuaj, nxënësit, prindërit, gjyshërit, miqtë dhe kolegët dhe ndihmohuni ata të kuptojnë dhe të bëhen aktivë në botën tonë dixhitale.

## Çfarë është Code Week?

EU Code Week është një lëvizje rrënjësore e drejtuar nga vullnetarë të cilët promovojnë kodimin në vendet e tyre si Ambasadorë të Code Week. Të gjithë organizuesit e evenimenteve të kodimit – shkollat, mësuesit, klubet e kodimit, bibliotekat, bizneset, autoritetet publike - inkurajohen të publikojnë evenimentin e tyre në hartën e [codeweek.eu](http://codeweek.eu).

## Cili është qëllimi i Code Week?

- Të festojmë krijimin me kod
- Të fuqizojmë njerëzit
- Të ndërlihim njerëzit
- Të ngjallim më shumë interes për shkencën, teknologjinë, inxhinierinë dhe matematikën

## Cilat janë përfitimet e mia?

- Kodimi është argëtues!
- Kodimi është krijues! Njerëzimi, që në kohët e hershme ka krijuar me argjilë, gurë, tulla, letër dhe dru. Sot ne krijojmë edhe përmes kodimit.
- Kodimi është fuqizues! Përtej konsumimit të materialeve dixhitale; ju mund të krijoni vetë gjëra me kod dhe t'i bëni ato të aksesueshme për miliona individë. Ju mund të krijoni faqe interneti, lojëra apo të kontrolloni një kompjuter ose një robot me kod.
- Të kuptojmë botën. Gjërat tani janë gjithnjë e më shumë të ndërlihdura. Duke kuptuar se çfarë ndodh pas ekranit, na jep mundësinë të kuptojmë botën!
- Kodimi na mëson mendimin kompjuterik, zgjidhjen e problemeve, kreativitetin, arsyetimin kritik, mendimin analitik dhe punën në ekip.
- 90% e punëve sot kanë nevojë për individë me kompetenca dixhitale, duke përfshirë këtu edhe kodimin.



## Si të bëhem pjesë e EU Code Week?

- Koduesit mund të organizojnë seminare në shkollat lokale, hapësirat co-working, qendrat ose bibliotekat e komunitetit.
- Mësuesit që kodojnë mund të zhvillojnë orë mësimore kodimi, të ndajnë planet e tyre mësimore, të organizojnë seminare për kolegët.
- Mësuesit që nuk dinë të kodojnë (ende) mund të organizojnë seminare ose të ftojnë prindër, studentë ose kodues për të mësuar njëri-tjetrin si të kodojnë.
- Prindërit mund të inkurajojnë fëmijët e tyre të marrin pjesë në një seminar kodimi.
- Bizneset dhe organizatat jofitimprurëse mund të organizojnë seminare kodimi, të "huazojnë" personelin e tyre si trajnues në aktivitete për fillestarët, të organizojnë sfida argëtuese kodimi për studentë ose të ofrojnë sponsorizim për evenimente kodimi.
- Institucionet publike mund të organizojnë seminare kodimi ose diskutime në tavolinë të rrumbullakët në ambientet e tyre.
- Kushdo që merr pjesë në një aktivitet kodimi mund të ndajë përvojën e tij në faqen e EU Code Week dhe të frymëzojë të tjerët!

## Tregu i Përbashkët Dixhital

Komisioni Evropian mbështet EU Code Week dhe nisma të tjera për të përmirësuar kompetencat dixhitale në Evropë si pjesë e strategjisë së Tregut të Përbashkët Dixhital. Rritja e kompetencave dixhitale të Evropës është pjesë e Axhendës së Kompetencave të BE-së dhe Planit të masave të Edukimit Dixhital të BE-së.

## Rezultatet 2017

- 1,2 milionë individë të të gjitha moshave
- Mbi 50 vende në BE dhe më tej duke përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe Australinë, si edhe vende në Afrikë dhe Azi.

## Rezultatet 2016

- 970 000 individë, nga fëmijë e deri tek moshat madhore
- Mbi 50 vende në BE dhe më tej duke përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe Australinë, si edhe vende në Afrikë dhe Azi.

## Rezultatet 2015

- 570 000 individë, nga fëmijë e deri tek moshat madhore
- 48 vende në BE dhe më tej duke përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe Australinë, si edhe vende në Afrikë dhe Azi.



@CodeWeekEU

#CodeEU

#CodeWeek



CodeEU



[codeweek.eu](http://codeweek.eu)

